



A.nr.739/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës—Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Merlinda Ramaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.739/2026, të datës 06.07.2026, të parashtruar nga ankuesja L.M-P nga Mitrovica, kundër organit të punësimit/Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 20.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e parakohshme ankesa me numër A.nr.739/2026, e datës 06.07.2026, e parashtruar nga ankuesja L.M-P.

A r s y e t i m

Ankuesja, L.M-P (*tutje referuar ankuesja*), më datë 06.07.2026, përmes e-mailit ankesa.kpmschck@rks-gov.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.739/2026, kundër Vendimit me numër RAN0154928, të datës 02.07.2026, të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Mitrovicës së Jugut, lidhur me refuzimin e aplikacionit në procedurën e pranimit me numër të referencës: RN00019648, për pozitën e punës *Zyrtar për Gjendjen Civile*, të shpallur nga Komuna e Mitrovicës së Jugut.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të çështjes ka gjetur se ankesa **është e parakohshme**, sepse:

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se Komuna e Mitrovicës së Jugut me datë 04.05.2026, ka shpallur konkursin me numër të referencës: RN00019648, për pozitën e punës *Zyrtar për Gjendjen Civile*, me afat të aplikimit nga data 05.04.2026-03.06.2026.

Rrjedhimisht, sipas provave të lëndës del se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja, mirëpo, sipas Vendimit me numër RAN0154928 të datës 02.07.2026, të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Mitrovicës së Jugut, me arsyetimin se nuk plotëson përvojën e punës në fushën për të cilën zhvillohet procedura, nuk posedon dëshmi që ka 1 vit përvojë pune pas diplomimit dhe sipas Trust figurojnë vetëm 4 muaj dhe si pasojë të njëjtës i është refuzuar aplikacioni.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,

pretendon së ka dorëzuar referencën e punës nga FU Bauhaus, kontratën e punës dhe dokumentet e tjera që dëshmojnë përvojën e punës. Kërkon që të aprovohet ankesa, të shfuqizohet Vendimi për refuzim të aplikacionit dhe të kthehet aplikacioni i ankueses në rivlerësim.

Në kuptim të pranushmërisë së ankesës, Kolegji i Këshillit, ju referua dispozitave të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë gjegjësisht, nenit 39, paragrafi 12 i cili përcakton se: “12. Kandidatet/ët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK sipas afatit të përcaktuar në ligjin përkatës për procedurën administrative”, si dhe nenit 17 të Rregullores 07/2025 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, me të cilin shprehimisht parashihet se: “Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve”, dhe rrjedhimisht konstatoi se ankesa e ankueses e parashtruar më datë 06.07.2026, kundër refuzimit të aplikacionit për pozitën e lartcekur është e parakohshme, ngase, me dispozitat përkatëse ligjore, kandidati/ja për pranim në Shërbimin Civil ka të drejtë të parashtoj ankesë vetëm pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të procedurës së rekrutimit, ndërsa, ankuesja ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e ka parashtruar kundër vendimit për refuzim të aplikacionit si veprim procedural në fazën e shqyrtimit paraprak. Andaj, duke qenë së në kohën e parashtrimit të ankesës më datë 06.07.2026, nuk kishte përfunduar procedura e pranimi sipas konkursit me Nr.Ref: RN00019648, rrjedhë se ankesa e ankueses është e parakohshme dhe për rrjedhojë e njëjta është e palejueshme në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në ndërlidhje me nenin 39, paragrafi 12 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Lidhur me të drejtën në mjete juridike, Kolegji i Këshillit thekson faktin së hedhja poshtë si parakohshme e ankesës me numër A.nr.739/2026 nuk mohon të drejtën e ankuesit që të kundërshtoj ligjshmërinë e refuzimit të aplikacionit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare si akt mbi përfundimin e konkursit lidhur me pozitën përkatëse.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë Juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë-Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.739/2026

Merlinda RAMAJ

Ardita Haxhnikaj DEMI

Procesmbajtëse

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, L.M-P;
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Mitrovicës së Jugut; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.